



BASHKIA PRRENJAS

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

”SISTEMIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS SE FSHATIT
PISHKASH, NJËSIA ADMINISTRATIVE QUKËS, BASHKIA PRRENJAS”

BASHKIA PRRENJAS

TABELA PERMBLEDHESE

1. Informacion per qellimin e VNM dhe metodiken e zbatuar
2. Kuadri Ligjor dhe Metodologjia e Ndjekur;
3. Pershkrimi i gjendjes se mjedisit prane zones se projektit
4. Raport paraprak i vleresimit te ndikimit ne mjedis
5. Vleresimi i ndikimeve negative te mundshme ne mjedis nga projekti
6. Program monitorimi
7. Vleresimi i ndikimeve positive qe mund te sjelle zhvillimi i projektit te propozuar
8. Konkluzione

H Y R J E

1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR

Shqipëria, si palë nënshkruese e një numri konventash ndërkombëtare, kontratave dhe dokumentave të tjera ligjore është e detyruar të zbatojë një sistem efektit për administrimin e tokës, ujit dhe ajrit, jo vetëm në drejtim të zgjidhjes së problemit, por edhe të zbatimit të përgjegjësive të saj nën këto marrëveshje ndërkombëtare.

Mbrojtja e mjedisit, si një sistem dinamik, që ndryshon herë pas here fizikisht dhe biologjikisht, duhet parë në tërësinë e faktorëve natyrorë dhe të veprimit njerëzor që ushtrohet mbi të. Zhvillimi i turizmit në Bashkinë Prrenjas jep një ndikim të caktuar, duke goditur pak a shumë natyrën përreth, sidomos kur parametrat e ndërtimit dhe të menaxhimit të tij nuk analizohen konform ligjeve e rregullave të natyrës, në dobi të ruatjes së ekuilibrave e të ekosistemeve të saj.

Një ndër burimet e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit janë zhvillimet urbane, që sipas natyrës dhe mënyrës teknike të aplikuar shkaktojnë ndotje, me sasi dhe natyra të ndryshme, midis të cilave më të rëndësishme janë:

- Gjatë operacioneve të ndërtimit, dhe pastaj edhe të funksionimit;
- Sistemi teknologjik i furnizimit me lëndë të parë dhe eliminimi i mbetjeve të tyre;
- Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit;
- Sistemi mbrojtës nga përmytjet dhe rreziqet e mundshme natyrore;

Metodat e uljes së ndotjes, në zhvillime urbane si qendra banimi, biznesi, shlodhëse, etj, konsistojnë në perfeksionimin e teknikave të mirëmbatjes dhe mirë menaxhimit të zonave të komplekseve të ndërtimit, por mbi të gjitha në marrjen e masave kundrejt atyre faktorëve që mund të ndikojnë negativisht ndaj parametrave natyror e shëndetësor. Këto ndërtime japin një efekt të caktuar, duke goditur pak a shumë natyrën përreth, sidomos kur parametrat e ndikimit të saj nuk analizohen konform ligjeve e rregullave të natyrës, në dobi të ruatjes së ekuilibrave e të ekosistemeve të saj.

Nxitja e tyre kërkon një përkujdesje më të madhe nga ana e organeve legjislativë dhe vendimmarrëse, në mënyrë që të rritet interesi për ndërtime dhe aktivitete të tilla, si dhe shoqëria investuese duhet të tregojë interes, si për zhvillimet në fushën e ndërtimit, dhe në ruatjen e ekuilibrave natyror, dhe veçanërisht në ruatjen e ekosistemeve.

1.1- Pershkrimi i pergjithshem


Vendi përfitues i këtij projekti është rruga e fshatit Pishkash , njësi administrative Qukës, Bashkia Prrerjas.


Ky segment rrugor është shumë i rëndësishëm për zonën pasi rregullon qarkullimin e banorëve të kësaj zone.

Rruga ka një gjendje ekzistuese jo të pershtatshme për qarkullimin e mjeteve. Gjatë periudhës së dimrit kjo rrugë bëhet edhe më e vështirë për qarkullim pasi nuk ka një sistemim për ujrat e skarpates që kufizon rrugën.

Pamje te gjendjes se rruges









2. KUADRI LIGJOR DHE METODOLOGJIA E NDJEKUR

Zona në studim është nën administrimin e Bashkisë Prrrenjas.

Projekti i zbatimit “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës së fshatit Pishkash, njësi administrative Qukës, bashkia Prrrenjas”

Bashkia Prrrenjas në bazë të Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “ Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis “, Neni 8

“ Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së “ ku thuhet: Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:

a) projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur;

Shtojca II

Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis

Prodhime infrastrukturore.

a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale;

b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat;

c) Ndërtim rrugësh, portesh dhe instalimesh për porte, duke përfshirë dhe portet e peshkimit (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I); do t'i nënshtrohet procedurës së këtij vlerësimi.

Tabela-4: Permbledhje e kuadrit ligjor mjedisor

Kuadri Ligjor	
Ligji Nr.10 431 datë 9.6.2011	Për mbrojtjen e Mjedisit
Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis
Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011	Për lejet e mjedisit
Ligji Nr.9362, datë 24.03.2005	Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve
Ligj nr. 10463 dt. 22.09.2011	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve
Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002	Për zonat e mbrojtura I ndryshuar me: - Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007	Për administrimin e zhurmës në mjedis
Ligji Nr. 107/2014, datë 31.7.2014	“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar me Ligjin Nr. 73/2015, datë 09.7.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”
Në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë janë miratuar edhe disa ligje në kuadër të përfshirjes së vendit tonë në Protokolle dhe Marrëveshje të ndryshme. Ndër to përmendim	
Ligji Nr. 9672, datë 26.10.2000	Për ratifikimin e konventës së Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në

	vendimmarrje, si dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit".
Ligji Nr. 9334, datë 16.12.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos në konventën për ndryshimet klimatike (UNFC).
Ligji Nr. 9048, datë 07.04.2003	"Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar. Ky ligj ka për qëllim shpalljen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë
Vendime të Këshillit të Ministrave	
VKM Nr 714 date 06.11.2019	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e këshillit të ministrave nr. 686, datë 29.7.2015 'për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklarates mjedisore'", të ndryshuar
VKM 686, datë 29.7.2015	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklarates mjedisore"
VKM Nr. 912, datë 11.11.2015	"Për Miratimin E Metodologjisë Kombëtare Të Procesit Të Vlerësimit Të Ndikimit Në Mjedis"
VKM Nr. 587, datë 7.07.2010	Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike.
VKM Nr. 676, datë 20.12.2002	Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror
VKM Nr.804, datë 4.11.2003	Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në mbrojtje.
VKM Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse.
VKM Nr.435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë.
VKM Nr.803, datë 4.12.2003	Për standardet e cilësisë së ajrit.
VKM Nr.994, datë 02.07.2008	Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin.
VKM Nr. 271, datë 6.4.2016	"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar.
VKM Nr. 408, datë 13.5.2015	"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"
VKM. Nr. 671, datë 29.7.2015	"Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit"
VKM Nr. 502, datë 13.7.2011	"Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit
Udhëzime dhe Rregullore	
Udhëzimi Nr. 1037/1, datë 12.04.2011	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore
Udhëzimi Nr. 8, datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527, datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre.

2.2 Qellimi, objektivat dhe metodologjia e ndjekur per hartimin e VNM-se

2.2.1 Qellimi dhe Objektivat e VNM-se

Objektivi kryesor i hartimit të VNM-së është të identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore

gjate zhvillimit të projektit duke marrë në konsideratë:

- Analizën e alternativave dhe ndikimet mjedisore shoqëruese;
- Të sigurohet që burimet janë përdorur si duhet dhe në mënyrë eficientë;
- Të identifikohen masat e duhura për zbutjen e ndikimeve të mundshme të propozimit;
- Të vendosen kushtet për ndërtimin;

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit të Mjedis bazuar në qëllimin e projektit është hartuar:

- Të japë informacion mbi vendndodhjen e sheshit të projektit dhe të analizojë tiparet mjedisore;
- Të japë informacion mbi projektin teknik, për fazën parapregaditore, të ndërtimit dhe rehabilitimit.
- Të vlerësojë ndikimet e mundshme në mjedisin përreth dhe në banorët e zones ku do zhvillohet projekti.
- Të përshkruajë masat për reduktimin apo evitimin e impakteve të analizuara;
- Të hartojë planin për monitorimin e mjedisit për të mbajtur nën kontroll ndikimet
- Të informojë institucionet vendore, komunitetin dhe grupet e tjera të interesit për zhvillimin e projektit;
- Të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime mbi rëndësinë e projektit në lidhje me ndikimet negative dhe pozitive si dhe rëndësinë sociale të tij.

Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshijnë përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejt mjedisore gjatë zbatimit apo mos zbatimit të projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit janë vlerësuar në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e implementimit të projektit referuar projektit teknik të ndërtimit të këtij objekti.

2.2.2 Metodologjia e ndjekur per hartimin e VNM-se

Hartimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është bazuar referuar VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.

Aspektet më të rëndësishme të procesit paraprak të VNM-së janë identifikimi i ndikimeve që mund të shkaktojë projekti , konsultimet me palët e tjera të interesuara/të ndikuara dhe vendimi, nëse kërkohet një VNM e thelluar për projektin e propozuar.

Duke pasur si qëllim kryesor vendimmarrje më të mira, për të vendosur për nevojën e VNM-së (paraprake ose të thelluar), për informacionin e nevojshëm që duhet të përfshihet në raportin e VNM-së, si dhe raporte VNM-je të cilësisë së lartë, është e nevojshme të kalohet, së pari, nëpërmjet Listës së Kontrollit të Klasifikimit (Shoshitje - Screening Checklist).

Tabela-2 Lista e kontrollit

Faza 1 Lista e kontrollit - Informacioni për t'u siguruar për VNM-në paraprake	Lista e kontrollit	
Përshkrimi i projektit të propozuar	PO	PO
a) Përshkrimi i qëllimit të projektit të propozuar	PO	PO
b) Planimetria e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës, që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo të funksionimit të veprimtarisë së projektit	PO	PO
c) Informacion për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe me të dhëna për distancën nga vendi ku propozohet projekti e për njësinë e qeverisjes vendore (bashkia/komuna), që administron territorin ku propozohet projekti	PO	PO
ç. Skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit	PO	PO
d) Përshkrim i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit	PO	PO
dh) Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja	PO	PO
e) Program për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit	PO	PO
ë) Mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit	PO	PO
f) Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji)	PO	PO
g) Informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit	PO	PO
gj) Informacion për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret	PO	PO
h) Të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe për mënyrën e sigurimit të tyre	PO	PO
i) Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo i rezidencave etj.	PO	PO
j) Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/licencimin e projektit	PO	PO
Raporti paraprak i VNM-së ku përfshihen	PO	PO
a) Një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, i shoqëruar dhe me imazhe	PO	PO
b) Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj	PO	PO
c) Një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër dhe shëndet	PO	PO
ç) Një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimi i mbetjeve	PO	PO

d) Informacion për peshën, evoluimin në kohë, kumulativitetin dhe kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara	PO	PO
dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të	PO	PO
e) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar, të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, përfshi edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin	PO	PO
ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis	PO	PO
f) Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë)	PO	PO
g) Program monitorimi për masat zbutëse, të cituara në pikën “i” të kësaj tablele	PO	PO
gj) Informacion mbi ndikimet pozitive që mund të sjellë zhvillimi i projektit të propozuar	PO	PO
h) Raporti paraprak i VNM-së duhet të jetë i nënshkruar nga personi fizik/juridik i licencuar nga QKL-ja,	PO	PO
i) Raporti paraprak i VNM-së duhet të jetë i shoqëruar me licencën e personit fizik/juridik të lëshuar nga QKL-ja, dhe certifikatën/certifikatat e ekspertit/ëve të certifikuar nga ministri i Mjedisit, me anë të të cilave është pajisur me licencën lëshuar nga QKL-ja	PO	PO

3. PERSHKRIMI I GJENDJES SE MJEDISIT PRANE ZONES SE PROJEKTIT

3.1.Klima


Bashkia e Prrenjasit, sipas ndarjes klimatike të Shqipërisë, ndodhet në zonën klimatike mesdhetare paramalore, në nënzonen klimatike mesdhetare paramalore jugore.

Larmia e formave të relievit të kësaj nënzone ndikon në regjimin e elementeve klimatik.

Pozicioni që ka kjo bashki, larg bregdetit= dhe në lartësi mbi nivelin e detit, bën që temperatura e ajrit të karakterizohet nga vlera relativisht e ulta. Kjo është me e theksuar gjatë stinës së dimrit ku ererat që fryjnë nga brendësia e territorit ndikojnë dukshëm në uljen e temperaturës. Temperatura mesatare e ajrit varion nga 2.7°C në Janar deri në 21°C në Korrik. Temperatura mesatare maksimale luhet nga 6.8°C në Janar deri në 28.2 °C në Korrik e Gusht.

Temperatura mesatare minimale luhet nga -1.4°C (Janar) deri në 13.8°C (Korrik).

Temperatura mesatare vjetore është 13.4°C.



Harta e kushteve klimatike-era (Burimi: Instituti I studimimeve klimatike)

3.2 Kushtet Gjeologjike Inxhinierike te Zones se Projektit

3.2.1 Metodologjia e ndjekur per hartimin e VNM-se

Rajoni ne te cilin shtrihet Bashkia e Perrenjasit, nga pikepamja gjeomorfologjike ndahet ne dy njesi:

- Njesia morfologjike kodrinore,
- Njesia morfologjike fushore

Tipet e relievit qe ndertojne siperfaqen e zones se studiuar jane:

- Relievi I tipit strukturoro-eroziv
- Reliev I tipit erozivo-denudues

Depozitimet e Triasikut te isperm-Jurasikut te poshtem (T₃-J₁)

Gelqeroret platformike te Triasikut te siperm-Jurasikut te poshtem kane perhapje teper te gjere ne zonen e Rrajces, pjesa lindore e masivit te Shebenikut si dhe ne pjesen perendimore te cilat takohen ne trajte pullash.

Shkembijnje ultrabazike

Perfaqesojne pjesen qendrore te masivit ultrabazik te Shebenikut dhe kane perhapje te konsiderueshme ne rajon. Duke filluar nga poshte-lart ne ndertimin gjeologjik marrin kero formacione:

Depozitimet e Kretakut te Siperme (Cr₂)

Keto depozitime dalin ne siperfaqe pa nderprerje qe nga vendburimi i Pishkashit deri te maja e Skroskes, Mandej nderpriten dhe shfaqen ne forme blloqesh deri ne vendburimin e Bushtrices duke perfshire edhe Bushtricen e siperme.

Depozitimet e Paleogjenit e Neogjenit

Kane perhapje shume te madhe dhe zene pjesen perendimore dhe juglindore te rajonit.

Dallohen depozitimet e Oligocenit, Akujtanian-Burdigalianit dhe Helvecianit.

Depozitimet Kuaternare

Zene pjese te uleta te relievit, dhe faqet e maleve. Gjate lumit te Bushtrices takohen aluvionet te perfaqesuara nga zaje ultrabazikesh, gelqeroresh e ranoresh te pa cimentuar. Ne te dy anet e lumit vihen re tarraca te vogla lumore me trashesi deri 30m.

Depozitimet deluviale, ksne perhapje te konsiderueshme. Keto depozitime mbulojne gjithë fushen e Rajces si dhe takohen ne pjeset me te uleta te shpateve kodrinore dhe ne luginat e perrenjeve dhe te lumenjeve.

Bazuar ne ndertimin gjeologjik dhe ujembajtjen, ne rajonin e Prrenjasit klasifikojme keto komplekse ujembajttese:

Kompleksi ujembajtes i shkembinjve te shkrifet – me ujembajtje mesatare


Kompleksi ujembajtes i shkembinjve kompakte, ku dallohen:

- a) Me ujembajtje mesatare deri te larte uniforme;
- b) Me ujembajtje mesatare;
- c) Me ujembajtje te ulet deri mesatare, jo uniforme;

Kompleksi ujembajtes i shkembinjve praktikisht pa uje, ku dallohen;

- a) Shkembinje te shkrifet pa uje;
- b) Shkembinje kompakt pa uje;

Harta gjeologjike e Republikës së Shqipërisë




3.2.2 Rreziku Sizmik

Prrenjasi ndodhet ne afersi te thyerjes tektonike regjionale (vijes sizmologjike) gjatesore jug-veri, Bilisht-Moker-Mat dhe asaj terthore lindje-perendim Lushnje-Elbasan_Diber. Si e tille kjo zone eshte e goditur here pas here nga termete te fuqishme.

Sipas rajonizimit sizmik te Shqiperise, qyteti i Prrenjasit futet ne zonen me intensitet termetesh 7-8 balle, kjo duhet vleresuar vazhdimisht nga projektuesit e ndertuesit.

Qyteti i Prrenjasit dhe zona perreth tij, ndodhet n ebrezin e fuqishem sizmik Peshkopi-Korce me shtrirje veri-jug. Nag ky brez sizmo-aktiv edhe ne ditet e sotme, sipas hartes se termeteve maksimal te pritshme, jane gjeneruar termete me magnitude maksimale te pritshme $M_{max}=6.5-7.0$

Qyteti i Prrenjasit dhe zona perreth tij eshte prekur nga disa termete te fuqishem, qe kane patur vatrat e tyre ne brezin sizmologjik Elbasan-Diber (termetet qe kane ndodhur ne rajonin Diber-Cermenike-Pogradec-Prrenjas) dhe brezin sizmologjik Peshkopi -Korce (termetet qe kane ndodhur ne rajonin Korce-Pogradec-Moker) dhe qe kane shkaktuar deme edhe ne hapesiren perreth qytetit te Prrenjasit.




Harta e rajonizimit sizmik

Sipas hartes se rajonizimit sizmik te vendit, Prrenjasi perfshihet ne njke zone ku Brenda 100 viteve rte ardhshem mund te priten termete me intensitet $I_{max}=8$ balle MKS-64 per kushte mesatare trualli.


3.2.3 Hidrologjia

Përshkrim i përgjithshëm i hidrologjisë së rajonit të projekti

Burimet hidrike të zonës janë mjaft të pasura dhe të larmishme në forme. Burimi kryesor është rrjedhja e sipërme e shtratit të lumit Shkumbin që formon dhe grabenen me tipike të zonës. Se dyti ka mjaft burime ujore malore që derdhen në të dyja shpatet kufizuese të lumit Shkumbin. Dhe se treti janë burimet ujore statie, pra liqenore (natyrore dhe artificiale) ku padyshim me të rëndësishme janë ato të liqeneve të Rrajces, por edhe rezervuaret e krijuar krijojnë mjedis me impact pozitiv mjedisor. Ujrat karakterizohen nga parapetra fiziko-kimik dhe organoleptik të pershtatshme për pirje por dhe për shfrytëzim në ekonomitë e njesive të vleresuara sipas origjinës së tyre. Zonat natyrore të mbrojtura ndodhen në basenin uje mbledhës të lumit të Bushtrices, i cili në këtë zonë ka prurje të mëdha, gjatësi totale Brenda zonës është 18.5 km dhe 7 km jashtë saj deri sa derdhet në Shkumbin. Në zallin e lumit të krijuar nga gerryerja e tokës gjendet bimesia si rrapë dhe shelgu etj. ajo që e bën të vërtetë këtë lumen është prania e ujërave të pastra e të embela, duke krijuar ambjentin e jetesës së Trofes së malit dhe të Lunderzës (lutra). Te dyja specie rrezikohen për tu zhdukur në këtë zonë. Perrenjtë kryesore që derdhen në lumin e Bushtrices janë, perroi i Moraves, i Kunjit, perroi i Peshkut, Perroi i Artinit, perroi i Skalaves dhe perroi i Shurit të Zi. Liqenet e Rrajces në Likopathër.



Harta e zonave klimatike te Shqiperise



Rreshjet

Rreth 66% te sasisë vjetore te reshjeve bien ne periudhën e ftohte te vitit dhe rreth 34% e tyre ne muajt e verës. Sasia vjetore e reshjeve është mesatarisht 1139mm.

Tabela jep shpërndarjen e reshjeve gjate vitit, reshjet maksimale absolute sipas muajve si dhe numrin e ditëve me reshje > 1.0 mm.


Shpërndarja vjetore e reshjeve dhe te indekseve te saj

Muaj	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Rreshjet	120.1	107.6	99.3	98.4	91.7	58.4	37.4	38.7	63.7	120.6	159.2	143.7
Max.24h	81.3	73.2	74	80.5	62.3	62.3	86.5	51.5	66.4	137.6	91.4	141.2
Nr>1.0mm	9.9	10.2	10.3	10.5	9.3	6.4	4.1	4.2	5.9	8.0	10.8	10.7

Siç shihet vlera maksimale e reshjeve 24 orësh 141.2 mm e regjistruar ne muajin dhjetor, është gati njëloj me maksimumin 24orësh te reshjeve regjistruar ne rrjedhjen e sipërme. Edhe shuma vjetore e reshjeve tregon se vetëm për rreth 100 mm me tepër është diferenca nga rrjedhja e sipërme.


Ndërkaq numri mesatar i ditëve me reshje >1.0 mm është 99.4 dite.

Ne më poshtë ne te cilin jepen ecuria vjetore e reshjeve mesatare dhe numri i ditëve me reshje >1.0 mm duket qarte ecuria e njëjte e tyre, pra vlerat me te larta regjistrohen ne muajt e ftohte te vitit dhe ato me te ulta ne muajt e verës.



Rreshjet mujore

Nje harte e shperndarjes zonale te dendesise se reshjeve gjate 24 oreve me probabilitet 1%:



Shperndarja zonale e reshjeve ditore neper Shqiperi

4. RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

4.1 Pershkrimi i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti

4.1.1 Metodologjia e zbatuar

Metodologjia e përdorur për vlerësimin e përgjithshëm botanik është kryer sipas dy etapave, nëpërmjet konsultimit me literaturën vendase dhe të huaj dhe ekspeditës në terren, për grumbullimin e materialit bimor.

Përcaktimi i specieve është kryer sipas çelësave të përcaktimit, të tillë si: “Flora e Shqipërisë” (Paparisto et al., 1988-2000), “Flora ekskursioniste e Shqipërisë” (Demiri, 1983), “Flora Europea” (Tuttin et. al, 1964 - 1980), “Udhëheqës fushor i florës së Shqipërisë” (Vangjeli, 2003).

Speciet e identifikuara janë listuar në tabelën floristike, ku janë organizuar të dhënat për:

- Emri latinisht (emrat janë përcaktuar sipas bazës së të dhënave Euro+Med plant database)
- Emri shqip (janë nxjerrë nga florat shqipëtare)
- Familja
- Forma Biologjike (sistemi Raunkier)
- Forma Korologjike
- Antropotoleranca sipas (Ettig, 1985)
- Statusi sipas Listës së Kuqe të florës dhe faunës së Shqipërisë (grup autorësh 2013)

Përcaktimi i formës biologjike është kryer sipas sistemit Raunkier,

- 1 Ph-Fanerofite, janë ato specie, të cilat nxjerrin sythet e tyre mbi 25 cm nga sipërfaqja e tokës.
- 2 Kamefitet, kane sythat të vendosur në lartësi të vogël nga toka (më pak se 25 cm), në mënyrë të tillë që të përdorin për mbrojtje bimësinë përreth, mbeturinat bimore apo dëborën.
- 3 Hemikriptofitet, janë bimë barishtore, të cilët i kanë sythat të vendosur në apo më lart se sipërfaqja e tokës. Mbrohen nga mbeturinat bimore shpesh nga gjethet e tyre të vdekura, ose nga dëbora. Shumica ruajnë një rozetë të gjelbër gjethesh gjatë dimrit. Bëjnë pjesë shumica e gramoreve.
- 4 Kriptofitet, kanë sythat të futur në tokë ose të zhytura në ujë dhe dallojmë:
 - a) Geofitet, të cilat kanë sythe që ndodhen nën sipërfaqen e tokës dhe ku përfshihen të gjitha bimët me bulb apo qepë, rizomë, zhardhokë të tilla si zambakët apo patatja etj.
 - b) Helofitet, bimë me rizomë të zhytur në ujë.
 - c) Hidrofitet, ose bimët ujore të vërteta që janë notuese ose të rrënjëzuara në ujë dhe me sythe brenda ujërave.
- 5 Terofitet, janë bimë njëvjeçare barishtore që kalojnë stinën e dimrit në gjendje fare. Përgjithësisht në këtë grup bëjnë pjesë llojet njëvjeçare.

Antropotoleranca është indikator i përhapjes gjeografike të bimëve sipas tolerancës ndaj ndikimit antropogjen. Ky parametër është përcaktuar kryesisht nga literatura bazë (Wittig, 1985; Mesiti & Dinga 2015, 2016; Buccheri & Martini, 2015; Stešević et. al., 2014). Sipas këtij parametri bimët ndahen në:

- a) Specie urbanofobe. Specie që rriten larg ndaj ndikimit urban.
- b) Specie urbanoneutrale. Janë ato bimë që rriten në habitate të ndryshme, pavarësisht pranisë ose jo të ndikimit antropogjen
- c) Specie urbanofile. Janë speciet që rriten kryesisht në vende me një intensitet të lartë urban.

Aspekti faunistic është i lidhur ngushtë me mjedisin rrethues. Ai paraqet një larmi biologjike mjaft të varfër që është po kështu një pasqyrim i gjendjes së këtij ekosistemi industrial minerar dhe të faunës pranë perrenjeve të kodrave të Katjelit.

Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kerkuar nga projekti dhe në afërsi të tij

4.1.2 Ujerat sipërfaqësor dhe nentokesorë

Përsa i përket hidrologjisë ajo është e shprehur në rajone me ujëra nentokesorë dhe ujëra sipërfaqësorë. Ujerat sipërfaqësorë janë ato të ujërave të shiut ose të prroskave që rrjedhin në drejtim të perroit të Katjelit dhe që zbresin poshtë në mënyrë natyrale. Ujerat nentokesorë nuk preken gjatë ndërtimit të rrugës ndërsa ato mbitokesorë sistemohen në kanalizime aty ku është e nevojshme.

4.1.3 Burimet e ujit të pijshëm në zonën e projektit

Në gjurmën e projektit dhe në afërsi me të nuk ka burime të ujit të pijshëm

Nuk ka asnjë burim i ujit të pijshëm në afërsi me zonën e projektit i cili do mund të ndikohet nga faza ndërtimore apo më pas.

4.2 Përshkrimi i zonave të mbrojtura dhe Monumenet e Natyrës

Rrjeti i Zonave të Mbrojtura, brenda Shqipërisë, përfshin disa kategori, të cilat mund të përcaktohen si më poshtë:

Kategoria I: Rezerva Vetëm për qëllime Natyrore/ Rezerva për qëllime Shkencore
Kategoria II: Park Kombëtar

Kategoria III: Monument Natyror

Kategoria IV: Rezerva Natyrore të Administruara/Zonë e Administruar e Specieve dhe Habitave
Kategoria V: Zonë Peisazhi e Mbrojtur

Kategoria VI: Zonë e Mbrojtur për Shumë Përdorime.

Referuar Hartës së Zonave të Mbrojtura të publikuar nga AKZM

(http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=item&layout=item&id=68&Itemid=36&lang=en)
rezulton se zona e projektit nuk ndërpret zona të mbrojtura dhe monumente të natyrës.



Harta e zonave të mbrojtura Shqiptare

Zona e projektit gjendet jashtë cdo zone të mbrojtur, larg monumenteve të natyrës apo burimeve natyrore.

Zona në studim nuk ben pjese as edhe në zonat e mbrojtura me interes të vecante qe mbrohen nga konventat nderkombetare si :Konventa mbi ligatinat me rëndësi ndërkombëtare veçanërisht si habitate të shpendëve ujore (konventa e Ramsarit); Konventa për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (Konventa e Bernës), etj

5 VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE TE MUNDSHME NE MJEDIS NGA PROJEKTI

5.1 Identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit (përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër dhe shëndet)

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme në mjedis i projektit të propozuar është bërë gjykuar mbi faktorët që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e funksionimit, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha nën kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis është analizuar sipas fazave të veprimtarisë si më poshtë: Sipas natyrës ndikimet klasifikohen në dy grupe të mëdha:

- Ndikime të kthyeshme;
- Ndikime të pakthyeshme;

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relativë ku qëllimi kryesor është mbajtja e ndikimit brenda sipërfaqes së çdo objekti dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim të proceseve komplekse të natyrës dhe rigjenerim të biodiversitetit.

Vetë natyra e aktivitetit të propozuar dikton ndikime dhe efekte të përhershme ose ndikime mbetëse në karakterin e mjedisit të sapokrijuar përgjatë gjithë tërësisë së tij, për zbutjen e të cilave propozohen masa konkrete.

5.1.1 Vlerësimi I Ndikimeve ne Mjedis

Në mënyrë të përgjithshme gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis për zhvillimin e këtij projekti janë analizuar ndikime potenciale negative të në mjedis për indikatorët me jdisore dhe social në vijim :

- Impakt në burimet ujore
- Impakt ne cilësine e ajrit
- Ndikimi në Biodiversitetin e zonës së projektit
- Ndikimi visual
- Zhurmat
- Impakti në Trafikun Rrugor
- Impakti ne Trashegimine Kulturore dhe Arkeologjike
- Impakti ndaj Mjedisëve të Punës dhe Shendetit Human
- Ndikim social
- Menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara

Klima dhe atmosfera

Aktivitetet e projektit të cilat mund të gjenerojnë një impakt mbi klimën janë heqja e bimësisë dhe prerja e drurëve që ndodhen në zonën e projektit. Këto aktivitete mbartin një transformim të zonës, e cila aktualisht ka një komponent termorregullator (ndonëse i ulët), duke rritur

sipërfaqen reflektuese, gjë që mund të çojë në një rritje të temperaturës së ambientit, rrezatimit diellor, evapotranspiracion potencial dhe uljen e nivelit të lagështisë. Shtrirja e këtyre efekteve është shumë e kufizuar dhe rivendosja e tyre në nivelet e mëparshme është pothuajse e plotë. Prandaj, impakti i projektit mbi klimën mund të konsiderohet jo i rëndësishëm.

Cilësia e ajrit

Duke iu referuar gjendjes aktuale të cilësisë së ajrit (Opsioni Zero), në zonë ka disa burime emetimi pluhurash dhe gazesh:

Kalimi i mjeteve në rrugën ekzistuese dhe në afërsi të saj;

Ngritja e pluhurave në ajër gjatë periudhave të nxehta me erë si pasojë e gjendjes së keqe të rrugës ekzistuese.

Cilësia e ajrit mund të përkeqësohet gjatë emetimit të pluhurave (transport dheu) dhe gazeve të djegies (përdorimi i mjeteve të rënda, rritja e trafikut) gjatë fazës së ndërtimit. Ky është një impact lokal, i kufizuar në zonën ku do të realizohen punimet. Gjithësesi, prania e erës mund të rrisë shtrirjen e tij.

Efekti potencial i përkeqësimit të cilësisë së ajrit nga emetimi i pluhurave dhe gazeve të djegies gjatë fazës së ndërtimit, është i dëmshëm, afatshkurtër, lokal, i kthyeshëm, periodik, jo akumulativ dhe jo i drejtpërdrejtë, me magnitudë dhe incidencë të ulët dhe mund të konsiderohet i pranueshëm.

Zhurmat dhe vibracionet

Realizimi i punimeve të rikonstruksionit/ndërtimit, do të shoqërohet me përdorimin e makinerive të rënda, kompresorëve, pompave, betonierave dhe pajisjeve të tjera për përgatitjen e zonës dhe ndërtimin e objekteve. Rritja e trafikut shkaktuar nga transporti i personelit dhe i materialeve, ngarkim-shkarkimi i materialeve, do të shkaktojë emetim zhurmash dhe vibracionesh.

Ky impakt është invers proporcional me nivelin e zhurmës së sfondit (Opsioni Zero), që do të thotë se në ato zona ku niveli i zhurmës së sfondit është i lartë, impakti i zhurmës është i ulët. Këtu duhet mbajtur parasysh që punimet do të kryhen jo shumë pranë zonave të banuara.

Efekti potencial i shkaktuar nga zhurmat dhe vibracionet gjatë fazës së ndërtimit, është i dëmshëm, afatshkurtër, lokal, i kthyeshëm, periodik, jo akumulativ dhe jo i drejtpërdrejtë, me magnitudë dhe incidencë të ulët dhe mund të konsiderohet i pranueshëm.

Erërat

Gjatë realizimit të punimeve të rikonstruksionit/ndërtimit, nuk priten erëra. Në raste të veçanta, kryerja e punimeve lidhur me prerjen e asfaltit ose shtrimin e rrugës, gjatë të cilave përdoren materiale si bitumi, mund të shkaktojë emetim erërash.

Gjithësesi, efekti potencial i këtij impakti mund të konsiderohet i parëndësishëm.

Ndriçimi

Gjatë punimeve të realizimit të veprave, mund të kërkohet përdorimi i ndriçuesave për krijimin e ndriçimit të nevojshëm për realizimin e punimeve, kryesisht gjatë stinës së dimrit dhe në orët e vona të pasdites.

Efekti potencial i shkaktoar nga ndriçimi gjatë fazës së ndërtimit, është i dëmshëm, afatshkurtër, lokal, i kthyeshëm, periodik, jo akumulativ dhe jo i drejtpërdrejtë, me magnitudë dhe incidencë të ulët dhe mund të konsiderohet i pranueshëm.

Gjeologjia dhe gjeomorfologjia

Aktivitetet e projektit të cilat mund të shkaktojnë një ndryshim të gjeologjisë dhe gjeomorfologjisë kanë të bëjnë kryesisht me lëvizjet e dheut (heqja e shtresës vegjetative dhe germimet), si dhe me depozitimin e materialit të gërmuar. Projekti parashikon ndërtimin e veprave mbajtëse gjeoteknike (mure mbajtës), të cilat garantojnë qëndrueshmërinë në rrëshqitje dhe përmbysje të shpateve natyrore ose artificialë.

Efekti potencial mbi gjeologjinë dhe gjeomorfologjinë gjatë fazës së ndërtimit, është i dëmshëm, afatgjatë, lokal, i pakthyeshëm, i rastësishëm, jo akumulativ dhe i drejtpërdrejtë, me magnitudë të ulët dhe incidencë mesatare dhe mund të konsiderohet i pranueshëm.

Trualli dhe përdorimi i tokës

Trualli

Ndërtimi i veprave të rikonstruksionit/ndërtimit, mund të shkaktojë dy efekte të dëmshme: Degradimi dhe erozioni i truallit si pasojë e punimeve të gërmimit dhe evakuimit të dheut;

Ndotje si pasojë e derdhjeve të lëndës djegëse, vajrave hidraulikë, etj, të cilat vijnë prej makinerive dhe mjeteve.

Shtresa e sipërme e tokës (0 – 1 m) pas heqjes së saj do të depozitohet me kujdes. Gjatë dhe pas përfundimit të punimeve, kjo shtresë do ripërdoret si dhë për mbjelljen e pemëve gjatë rrugës dhe në zona të tjera.

Efekti potencial mbi truallin gjatë fazës së ndërtimit, është i dëmshëm, afatmesëm, lokal, i kthyeshëm, periodik, jo akumulativ dhe i drejtpërdrejtë, me magnitudë dhe incidencë të ulët dhe mund të konsiderohet i pranueshëm.

Përgjithësisht, gjatë punimeve të ndërtimit shpesh ndodhin derdhje aksidentale të lëndës djegëse dhe lubrifikantëve. Po ashtu, edhe gjatë punimeve të betonimit, mund të ndodhin derdhje të betonit mbi tokë.

Me marrjen e masave parandaluese dhe korrigjuese, ky impakt zbutet mjaft. Për pasojë, efekti është i dëmshëm, afatshkurtër, lokal, i kthyeshëm, i rastësishëm, jo akumulativ dhe i drejtpërdrejtë, me magnitudë dhe incidencë të ulët dhe mund të konsiderohet i pranueshëm.

Përdorimi i tokës

Realizimi i projektit të rikonstruksionit/ndërtimit, pavarësisht natyrës së lokalizuar të projektit, do të shoqërohet me ndryshimin e destinacionit ose regjimit kadastral të tokës përgjatë gjatësisë së tij.

Ky aks rrugor ka një gjatësi rreth 1294 m.

Nga kalimi dhe zgjerimi i rrugës, rezulton që nga trupi i saj të zihen sipërfaqe suplementare, tokë bujqësore, truall ndërtimi etj.

Për të zbutur efektet socio-ekonomike, do të vlerësohet toka që zihet, ndonjë ndërtim minimal, shtëpi, etj, ndërtimet e përkohshme dhe ato definitive etj, duke synuar edhe një përcaktim të drejtë të shpronësimeve dhe prishjeve të mundshme, për të liruar sa më parë sheshin e ndërtimit dhe për të realizuar investimin e planifikuar.

Pas investigimeve të kryera në terren gjatë fazës së projekt-zbatimit, janë përpiluar tashmë në mënyrë të qartë dhe të hollësishme listat e pronarëve që shpronësohen, sipërfaqet e

objekteve apo trojeve së bashku me planimetritë e objekteve dhe genplanet e trojeve, si dhe vlera e plotë e shpronësimit, të shoqëruara me planimetritë e shpronësimeve mbi hartat treguese të ZVRPP-te, duke bërë edhe verifikimin e tyre në terren.

Prandaj, impakti i projektit mbi tokën mund të konsiderohet i moderuar.

Hidrologjia dhe hidrogeologjia

Punimet e ndërtimit të rrugës dhe veprave (heqja e shtresës vegjetative, gërmimet, depozitimi i materialit të gërmuar, punimet e betonimit, etj.) pritet të kenë një ndikim mbi cilësinë e ujit të tij, si dhe mbi cilësinë e ujrave nëntokësorë. Heqja e vegjetacionit do të rrisë sasinë e rrjedhjes sipërfaqësore të rreshjeve, ndërkohë që kompaktimi dhe veshja me beton e truallit do të ulë infiltrimet e ujit në tokë.

Efekti potencial mbi hidrologjinë dhe hidrogeologjinë gjatë fazës së ndërtimit, është i dëmshëm, afatmesëm, lokal, i kthyeshëm, periodik, jo akumulativ dhe i drejtpërdrejtë, me magnitudë dhe incidencë mesatare dhe mund të konsiderohet i moderuar.

Flora dhe fauna

Prerja e drurëve dhe heqja e shtresës vegjetative në zonën e projektit, do të gjenerojë një efekt të dëmshëm mbi florën. Ndikim mund të ketë edhe flora për shkak të eliminimit të bimësisë, si pasojë e modifikimit të habitateve dhe ekosistemeve. Impakti më i rëndësishëm mbi faunën do të ndodhë gjatë fazës së punimeve të ndërtimit (nivel i lartë zhurmash, zënie e trojeve, etj.).

Me marrjen e masave korrigjuese, si p.sh rimbjellja e drurëve dhe veshja e skarpatave me bimësi aty ku është e mundur, mund të arrihet zbutja e këtij impakti.

Efekti i projektit mbi florën dhe faunën, është i dëmshëm, afatmesëm, lokal, i kthyeshëm, periodik, jo akumulativ dhe i drejtpërdrejtë, me magnitudë dhe incidencë të ulët dhe mund të konsiderohet i pranueshëm.

Zonat natyrore

Nuk priten impakte mbi zonat natyrore të mbrojtura.

Peisazhi

Dy janë efektet kryesore që mund të priten gjatë fazës ndërtimore:

Një efekt i dëmshëm subjektiv si rezultat i parregullsive dhe kaosit që gjeneron organizimi i papërshtatshëm i depozitimit të materialeve, prania e mjeteve dhe makinerive, etj.;

Një efekt i përgjithshëm jo estetik shkaktuar nga grumbujt e materialeve të gjermuar dhe makineritë, të cilat çojnë në një ndryshim të peisazhit (ngjyrat, teksturën, etj.) dhe alteron karakteristikat vizuale. Një impakt të tillë e ka edhe heqja e shtresës vegjetative.

Efekti i projektit mbi peisazhin, është i dëmshëm, afatmesëm, lokal, i kthyeshëm, i vazhduar, jo kumulativ dhe i drejtpërdrejtë, me magnitudë dhe incidencë mesatare dhe mund të konsiderohet i moderuar.

Socioekonomia

Nga pikëpamja socioekonomike, pritet që efektet e projektit të jenë pozitive. Kjo për arsye të punësimit të fuqisë punëtore lokale. Nuk priten impakte negative.

Shëndeti publik

Aktivitetet e ndryshme të projektit, siç janë transporti i dherave, kalimi i makinerive, trafiku i makinerive të rënda dhe depozitimi i materialit të gjermuar, mund të shkaktojnë një efekt të padëshëruar mbi jetesën në zonë, si rezultat i ekspozimit ndaj pluhurit, zhurmës dhe vibracioneve. Pluhuri mund të bëhet shqetësues kur ai bie mbi dritaret dhe mjetet dhe kur futet në banesa. Gjenerimi i mbetjeve mund të kthehet në një burim sëmundjesh, por një menaxhim i përshtatshëm i tyre mund ta eliminojë këtë efekt. Me marrjen e masave parandaluese dhe korrigjuese me qëllim kontrollin e këtyre emetimeve, efekti do të zbutet mjaft.

Efekti i projektit mbi shëndetin publik, është i dëmshëm, afatshkurtër, lokal, i kthyeshëm, periodik, jo kumulativ dhe i drejtpërdrejtë, me magnitudë mesatare dhe incidencë të ulët dhe mund të konsiderohet i pranueshëm.

Trashëgimia historike dhe kulturore

Nuk ka të dhëna që pranë zonës në të cilën zhvillohet projekti, ka objekte historike, objekte kulti apo objekte të tjera me status të veçantë. Për këtë arsye, nuk priten impakte.

Tabela e mëposhtme paraqet matricën e vlerësimit të impakteve të pritshëm gjatë ndërtimit të veprës mbrojtëse. Impakti global gjatë fazës së ndërtimit rezulton i pranueshëm.

5.1.2 Përshkrimi i impakteve dhe vlerësimi i tyre

Në këtë seksion jepen rezultatet e vlerësimit mbi efektet kryesore mjedisore dhe sociale të cilat ndodhin gjatë fazës së zbatimit dhe operimit të projektit për realizimin e objektit “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës së fshatit Pishkash, njësia administrative Qukës, bashkia Prrenjas”.

Elementët mjedisorë të cilët janë marrë në studim janë:

- Klima dhe ajri;
- Gjeologjia dhe gjeomorfologjia;
- Toka dhe përdorimi i saj;
- Hidrologjia dhe hidrogeologjia;
- Flora, fauna dhe zonat e mbrojtura;
- Peisazhi;
- Efektet socio-ekonomike; Shëndeti publik;
- Trashëgimia historike dhe kulturore.

Metodologjia

Identifikimi i impakteve kryesore është realizuar duke mbivendosur informacionet lidhur me aktivitetet e projektit të cilat mendohet se kanë impakt mbi mjedisin dhe mjedisin në të cilin ato ndodhin. Është përdorur procedura matricore, e bazuar në metodën klasike të Matricës Leopold (shkak –pasojë) e përshtatur për raportin e VNM në studim. Për secilin element, janë studjuar aspektet emëposhtme:

- ❖ Përshkrimi i impaktit eventualisht i shkaktuar nga aktivitetet e projektit dhe caktimi i një shënje (pozitiv/i dobishëm ose negativ/i dëmshëm). Rezultatet janë pasqyruar nëpërmjet matricës së sipërpërmendur.
- ❖ Vendosja e një klasifikimi të impakteve, në varësi të rëndësisë globale të tyre. Në këtë mënyrë, impaktet e parëndësishme nuk janë marrë në konsideratë në raport me impaktet e rëndësishme. Objektivi është pasqyrimi i problemeve reale mjedisore (impaktet e rëndësishme) të lidhura me zbatimin dhe operimin e projektit të sistemit të rrugës.
- ❖ Kur një efekt konsiderohet si i parëndësishëm ose pa ndikim, pavarësisht nga efektet e tjerë, ai klasifikohet si “ i neglizhueshëm “ dhe nuk vlerësohet.

- ❖ Nga pikëpamja metodologjike, çdo vlerësim impakti, është nxjerrë në mënyrë cilësore, duke analizuar veç e veç Magnitudën dhe Incidencën (rëndësinë), dhe më pas është përcaktuar

Pesha:

$Pesha = f(\text{Magnituda}, \text{Incidencia})$

Si një alternativë e kësaj metodologjie, mundësia e kryerjes së një vlerësimi sasior është marrë në konsideratë, por përfundimisht nuk është realizuar, për shkak të pasigurisë së lartë të vlerësimit, e cila mund të çonte në konkluzione të gabuara.

Kriteret e vlerësimit të aplikuar në këtë raport janë shpjeguar më poshtë. Këto kriteret kanë të bëjnë me aspekte të tilla si magnituda, konteksti hapësinor i impakteve të projektit, konteksti kohor, reversibiliteti, rimarrja, frekuenca, akumulimi, menjëherëshmëria dhe rëndësia e efekteve potenciale gjatë zbatimit dhe operimit të projektit.

Klasifikimi i impakteve fokusohet në impaktet e zbutura, të cilat arrihen pas implementimit të masave korrektive dhe parandaluese të përshkruara në këtë raport.

- ❖ Magnituda e impaktit varet nga cilësia dhe sasia e elementit të ndikuar. Lidhur me cilësinë, vlerësimi është bërë bazuar në konkluzionet e inventarit mjedisor. Në fakt, i njëjti veprim i projektit mund të prodhojë një efekt të ndryshëm në varësi të cilësisë së momentit të elementit (ujë, ajër, tokë, flora dhe fauna, peisazhi, etj.). Vlerësimi i magnitudës përfundimtare është kryer duke patur parasysh standartet mjedisore dhe limitet, siç tregohet më poshtë.

Tabela 1: Kriteret e përdorur për vlerësimin e magnitudës së impakteve.

<i>SHKALLA PËR MAGNITUDËN</i>	<i>PËRCAKTIMI</i>
<i>E ulët</i>	<i>Efekti potencial është nën standartet/limitet mjedisore të aprovuar</i>
<i>Mesatare</i>	<i>Efekti potencial është i detektueshëm por përmbush standartet/limitet mjedisore të aprovuar</i>
<i>E lartë</i>	<i>Efekti potencial është mbi standartet/limitet mjedisore të aprovuar</i>

- ❖ Incidenca (rëndësia) e impaktit ka të bëjë me ashpërsinë, shkallën dhe formën e alterimit, të cilat janë treguar në tabelën e mëposhtme me anën etributeve. Vlerësimi përfundimtar i incidencës varet nga vlerësimi individual i secilit atribut dhe bëhet në tri shkallë vlerësimi si magnituda (e ulët, mesatare, e lartë).

Tabela 2: Kriteret e përdorur për vlerësimin e incidencës së impakteve

KRITERET E VLERËSIMIT	PËRCAKTIMI	SHKALLA	
Karakterit	Efekt pozitiv (I dobishëm) ose efekt negativ (I demshëm)	I dobishëm	Resursi ose elementi I studjuar mund të përmirësohet si rezultat i efekteve të projektit
		I demshëm	Resursi ose elementi I studjuar mund të përkeqësohet si rezultat i efekteve të projektit
Kohëzgjatja	Kohëzgjatja e efektit mbetet	Afatshkurtër	Kohëzgjatja e efektit është më e vogël se një vit
		Afatmesëm	Kohëzgjatja e efektit është më e madhe se një vit por më e vogël se pesë vjet
		Afatgjatë	Kohëzgjatja e efektit është më e madhe se pesë vjet
Shtrirja	Konteksti hapësinor i vendit të efektit	Zona lokale	Zona e përfshirë brenda rrezes 250 m nga vendi ku realizohet projekti
		Zona e zgjeruar	Jashtë zonës lokale
Kthyeshmëria	Efekti kthehet në gjendjen fillestare menjëherë pas përfundimit të projektit	I kthyeshëm	Efekti potencial mund të sprapset
		I pakthyesëm	Efekti potencial nuk mund të sprapset pavarësisht nga masat zbutëse
Frekuenca	Sa shpesh ndodh dukuria që shkakton efektin mbetet	I rastësishëm	Dukuria ndodh me ndërprerje
		Periodik	Dukuria ndodh me ndërprerje por në mënyrë të përsëritur gjatë zbatimit dhe operimit të projektit
		I vazhduar	Dukuria është e vazhduar gjatë periudhës së vlerësimit
Akumulimi	Rritje progressive e shfaqjes së dukurisë	Kumulativ	Magnituda e dukurisë rritet kur veprimi i projektit që e gjeneron mbetet
		Jo kumulativ	Magnituda e dukurisë nuk rritet kur veprimi i projektit që e gjeneron mbetet
Menjëherëshmëria	Marrëdhënia shkak-pasojë midis veprimit të projektit dhe elementit të ndikuar	I drejtpërdrejtë Veprimi i projektit shkakton një efekt të	Veprimi i projektit shkakton një efekt të drejtpërdrejtë mbi elementin e ndikuar
		Jo i drejtpërdrejtë	Veprimi i projektit nuk shkakton një efekt të drejtpërdrejtë mbi elementin e ndikuar, por ndikon me anën e mekanizmave shpërndarës

Pesha e një impakti bazohet në magnitudën dhe incidencën e tij, siç u tha më sipër.

Rezultati i këtij përcaktimi është shprehur nga ana cilësore në termat e specifikuar në standartet e VNM, ku diferencohen katër nivele ashpërsie: i pranueshëm, i moderuar, i ashpër dhe kritik, siç tregohet më poshtë.

Tabela 3: Kriteret e përdorur për vlerësimin e peshës së impakteve

SHKALLA E PESHËS	PËRCAKTIMI
<i>E pranueshme</i>	<i>Efekt me entitet të ulët eliminimi i të cilit është i menjëhershëm pas mbarimit të veprimit gjenerues</i>
<i>E moderuar</i>	<i>Eliminimi është i mundur me ose pa zbatimin e masave korrigjuese jo intensive, por kërkon një periudhë kohe</i>
<i>E ashpër</i>	<i>Magnituda e efektit kërkon zbatimin e masave korrigjuese, si dhe një periudhë të gjatë kohe për eliminimin e tij</i>
<i>Kritike</i>	<i>Magnituda e efektit është më e madhe se vlera e lejuar, duke rezultuar në një keqësim të vazhdueshëm të cilësisë së kushteve mjedisore, edhe nëse merren masa korrigjuese</i>

5.1.3 Përshkrimi dhe vlerësimi i impakteve të shkaktuar nga zbatimi i projektit

Aktivitetet kryesore të projektit, të cilët kanë më shumë gjasa të shkaktojnë impakte mjedisore, ndodhin gjatë realizimit dhe operimit të projektit të rikonstruksionit të rrugës. Më poshtë, janë përshkruar impaktet potencialë për të dyja fazat (Opsioni Projekt), duke patur parasysh gjendjen aktuale të elementëve mjedisorë (Opsioni Zero). Impaktet potencialë gjatë fazës së ndërtimit

Aktivitetet e mëposhtme gjatë fazës së ndërtimit mund të rezultojnë me impakte mjedisore:

1. Punimet e transportit të dherave (punë përgatitore në vendin e rikonstruksionit të rrugës):
 - Heqja e bimësisë;
 - Preerja e drurëve;
 - Heqja e shtresës vegjetative;
 - Punimet e gërmimit;
 - Stokimi i shtresës vegjetative dhe materialit të gërmuar;
 - Ngjeshja e dheut;
 - Transporti dhe depozitimi i materialit të gërmuar.
2. Ndërtimi i strukturave të ndryshme (vepra arti, mure mbajtëse, mbrojtja nga erozioni):
 - Punime betoni;
 - Ndërtimi i strukturave mbajtëse; Instalimet e mundshme (ndriçimi, etj.);
 - Implementimi i trotuareve dhe shtrimi i rrugës.
3. Makineritë dhe fuqia punëtore:
 - Lëvizja e makinerive të gërmimit;
 - Trafiku i mjeteve të rënda;
 - Fuqia punëtore.
4. Ngritja e kantierit (akomodimi i përkohshëm i fuqisë punëtore);
5. Administrimi i mbetjeve.

IMPAKTET	ELEMENT ËT E MËJEDISI T	MAGNIT UDA	SHTIRRI A	KARAKT ERI	KOHËZGJAT IA	KTHYESH MËRIA	FREKUEN CA	AKUMU LIMI	MENJËHERËS HMERIA	INCIDE NCA	PESHA
Fumetimi i pluhurit dhe i gazrave	Atmosfera (celësia e ajrit)	E ULËT	I	Atashkurter	Lokale	I kthyeshem	Periodik	Jo kumulativ	Jo i drejtpërdrejt	E ULËT	PRANUES HEM
Generimi i zhurmës dhe i vibracioneve	Atmosfera (zhurmat dhe vibracionet)	E ULËT	I	Atashkurter	Lokale	I kthyeshem	Periodik	Jo kumulativ	Jo i drejtpërdrejt	E ULËT	PRANUES HEM
Ndodja nga ndricimi	Atmosfera (ndricimi)	E ULËT	I	Atashkurter	Lokale	I kthyeshem	Periodik	Jo kumulativ	I drejtpërdrejt	E ULËT	PRANUES HEM
Alterime të gjeologjisë dhe gjeomorfologjisë	Gjeologjia dhe gjeomorfologjia	E ULËT	I	Atatigrafi	Lokale	I kthyeshem	I rastësishëm	Jo kumulativ	I drejtpërdrejt	MESATA RE	PRANUES EM
Degradimi dhe erozioni i trullit	Trulli	E ULËT	I	Atamnesëm	Lokale	I kthyeshem	Periodik	Jo kumulativ	I drejtpërdrejt	E ULËT	PRANUES EM
Ndodja e trullit nga derdhjet aksidentale	Trulli	E ULËT	I	Atashkurter	Lokale	I kthyeshem	Periodik	Jo kumulativ	I drejtpërdrejt	E ULËT	PRANUES HEM
Modifikimi i mjedhës ujore	Hidrologjia dhe hidrogjeologjia	MESATA RE	I	Atamnesëm	Lokale	I kthyeshem	Periodik	Jo kumulativ	I drejtpërdrejt	MESATA RE	MODERUA R
Ndodja e ujit nga derdhjet aksidentale	Hidrologjia dhe hidrogjeologjia	E ULËT	I	Atashkurter	Lokale	I kthyeshem	I rastësishëm	Jo kumulativ	Jo i drejtpërdrejt	E ULËT	PRANUES HEM
Shkatërrimi dhe ose dëmtimi i florës dhe faunës	Flora dhe fauna	E ULËT	I	Atamnesëm	Lokale	I kthyeshem	Periodik	Jo kumulativ	I drejtpërdrejt	E ULËT	PRANUES HEM
Ndrysime vizuale të peshazhit të tokës	Peisazhi	MESATA RE	I	Atamnesëm	Lokale	I kthyeshem	I vazhduar	Jo kumulativ	I drejtpërdrejt	MESATA RE	MODERUA R
Ekspozimi ndaj pluhurit, zhurmës dhe vibracioneve	Shtëndeti publik	MESATA RE	I	Atashkurter	Lokale	I kthyeshem	Periodik	Jo kumulativ	I drejtpërdrejt	E ULËT	PRANUES EM

Tabela 4 paraqet matricën identifikuese të impakteve të pritshëm gjatë ndërtimit të veprave:

5.1.4 Masat korigjuese dhe parandaluese

Masat e mëposhtme korigjuese dhe parandaluese rekomandohen të merren gjatë fazës së ndërtimit të rrugës dhe veprave, me qëllim zbutjen dhe eliminimin e efekteve negative. Veç këtyre masave, nga ana e Kontraktorit, është i detyrueshëm përpilimi i Planit të Sigurisë në punë dhe aplikimi i Kodeve të Praktikës së Mirë.

KLIMA DHE ATMOSFERA

Cilësia e ajrit

Impakti potencial: Përkeqësimi i cilësisë së ajrit si pasojë e emetimeve të pluhurave dhe gazeve gjatë fazës ndërtimore.

Masat zbutëse:

Reduktimi i pluhurave me anën e spërkatjes së pjesëve të rrugës të paasfaltuara dhe të vendeve të përkohshme të grumbullimit të mbetjeve në se është e nevojshme, sidomos gjatë periudhës së thatë.

Evitimi i mbingarkimit të mjeteve dhe mbulimi i ngarkesës gjatë transportit të dherave të gjermuar ose materialeve të tjerë kokrrizorë të cilët mund të sjellin dëmtime nga përhapja e pluhurave;

Qarkullimi i makinerive dhe mjeteve të transportit me shpejtësi të ulët në zonën e punimeve, me qëllim evitimin e ngritjes së pluhurave;

Punimet e gjermimit të shmangen gjatë kohës kur shpejtësia e erës është e lartë, me qëllim evitimin e përhapjes së pluhurave;

Të gjitha pajisjet, makineritë dhe mjetet e rënda duhet të fiken në se nuk janë në punë me qëllim evitimin e gjenerimit të gazeve të djegies;

Ushtrimi i kontrollit periodik mbi sasinë dhe cilësinë e gazeve të djegies për të gjitha makineritë dhe mjetet e rënda, përmbajtja e të cilave duhet të jetë në përputhje me normat në fuqi.

Impakti potencial: Efektet dëmtues të zhurmës dhe vibracioneve mund të ndodhin gjatë ndërtimit të rrugës dhe veprave.

Masat zbutëse:

Aktivitetet e ndërtimit do të kryhen sipas legjislacionit përkatës në fuqi për mbrojtjen nga zhurma, në lidhje me orët e punës dhe të niveleve të zhurmës;

Përzgjedhja e automjeteve të rënda dhe makinerive duhet të bëhet sipas rregullave dhe standardeve të zhurmës në fuqi. Ata duhet të jenë të pajisur me të dhënat teknike të prodhuesit

në lidhje me nivelin e zhurmës së gjeneruar sipas normave të Republikës së Shqipërisë ose normave të BE;

Planifikimi i duhur i punimeve gjeneruese të zhurmës (makineritë e rënda), duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të shmangen efektet dëmtuese mbi popullsinë. Këto lloj punimesh nuk duhet të kryhen gjatë natës (22.00 – 07.00), përveç në rastet e emergjencës, ose kur një pjesë kritike e punës duhet të përfundojë patjetër brenda një afati të caktuar; në këtë rast, është detyrueshme marrja e lejes nga Autoriteti Publik përkatës.

Impakti potencial: Efekte dëmtuese nga ndriçimi mund të ndodhin gjatë ndërtimit të veprave.

Masat zbutëse:

Në se është e nevojshme, gjatë punës ndriçuesit do të orientohen me pjerrësi poshtë, për të evituar dëmtimet ndaj banorëve në afërsi.

GJEOLGJIA DHE GJEOMORFOLOGJIA

Impakti potencial: Alterime të gjeologjisë dhe gjeomorfologjisë mund të shkaktohen gjatë ndërtimit të rrugës dhe veprave.

Masat zbutëse:

Ndërmarrja e një studimi gjeoteknik dhe rishikimi i projektit të zbatimit të veprave;

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet nivelit të ujrave nëntokësorë sidomos gjatë gjurmimeve të thella;

Marrja e masave të posaçme për evitimin ose kontrollin e filtrimeve, dhe përdorimi i materialeve me granulometri të përshtatshme për mbushje për të shmangur efektet e mundshme të kundërfiltrimit, në rastin e vendosjes së strukturës nën nivelin e ujrave nëntokësore;

Përfshirja e studimit sizmik në projektin e zbatimit të veprës;

Ripërdorimi për mbushje ose punime të tjera i materialit të gërmuar sa më shumë të jetë e mundur, me qëllim që të evitohet depozitimi i tij në landfill ose në vende të tjera përkohësisht; Në rastet kur është e nevojshme, depozitimi i materialit të gërmuar do të bëhet në landfill;

Në rastet kur huazimi i tokës për depozitimin e materialit të gërmuar është i nevojshëm, mund të përdoren karrierat ekzistuese. Nëse duhet të hapet një karrierë e re, kjo do të bëhet në bazë të lejes përkatëse.

PËRDORIMI I TOKËS

Impakti potencial: Degradimi i truallit dhe erozioni i tij gjatë ndërtimit të rrugës dhe veprave.
Masat zbutëse:

Kufizimi i zonës brenda të cilës do të zhvillohen punimet përpara dhe gjatë këtyre të fundit;

Përdorimi i rrugëve ekzistuese nga mjetet e rënda dhe makineritë për t'u futur në zonën e punimeve;

Shtresa e sipërme e tokës (thellësi 0 – 1 m) do të ripërdoret si dhé për mbjelljen e pemëve të reja përgjatë veprës.

Impakt potencial: Ndotja e tokës nga derdhjet aksidentale gjatë ndërtimit të rrugës dhe veprave.

Masat zbutëse:

Furnizimi i makinerive me karburant, mirëmbajtja dhe larja e tyre do të bëhet në vende të përshtatshme;

Mbledhja, transporti dhe menaxhimi i mbetjeve do të bëhet në përputhje me legjislacionin dhe standartet në fuqi mbi mbetjet;

Stokimi, transporti dhe menaxhimi i kimikateve dhe materialeve të tjera të rrezikshme do të bëhet në bazë të rregullave dhe stansarteve në fuqi;

Njollat do të hiqen duke përdorur material absorbues; më pas bëhet menaxhimi i materialit të hequr si mbetje e rrezikshme;

Njollat e betonit do të hiqen dhe do të trajtohen si mbetje ndërtimi;

Implementimi i një plani menaxhimi mjedisor gjatë fazës së ndërtimit. Ky plan do të përcaktojë mënyrën e transportit të materialeve të rrezikshme, parandalimin dhe eliminimin e derdhjeve, menaxhimin e mbetjeve, transportin dhe derdhjen e betonit, si dhe planet e tjerë të rreziqeve.

Implementimi i Planit të Menaxhimit Mjedisor do të kryhet nëpërmjet trajnimit të personelit.

HIDROLOGJIA DHE HIDROGJEOLOGJIA

Impakt potencial: Ndotja e ujrave nga derdhjet aksidentale gjatë ndërtimit të rrugës dhe veprave.

Masat zbutëse:

Aplikimi i të gjitha masave zbutëse të përmendura më sipër për mbrojtjen e tokës nga ndotja;

Krijimi i kushteve të sigurta të punës nëpërmjet drenazhimit të gërmimeve. Uji i pompuar do të depozitohet në një rezervuar dekantimi dhe pastaj do të derdhet në kanalizimet e ujrave të bardha;

Ndërtimi i sistemit të drenazhit të ujrave sipërfaqësore dhe dërgimi i tyre në rezervuarin e dekantimit me gravitet;

Mjediset hidrosanitare për personelin të pajisen me impiantin e trajtimit të ujrave të përdorura (gropë septike);

Uji i përdorur për shplarjen e makinerive të betonit të largohet nga zona drejt trajtimit.

FLORA, FAUNA DHE ZONAT NATYRORE TË MBROJTURA FLORA DHE FAUNA

Impakti potencial: Shkatërimi dhe/ose dëmtimi i florës dhe faunës gjatë ndërtimit të rrugës dhe veprave.

Masat zbutëse:

Lëvizja e mjeteve dhe makinerive jashtë zonës së projektit nuk do të lejohet, me qëllim evitimin e dëmtimit dhe humbjes së vegetacionit natyral, i cili ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e truallit;

Shtresa e sipërme e tokës (thellësi 0 – 1 m) do të ripërdoret si dhë për mbjelljen e pemëve të reja përgjatë rrugës dhe sheshit. Aplikimi i të gjitha masave mbrojtëse të përshkruara për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (mbrojtja nga pluhurat, emetimet e gazeve, zhurmat, vibracionet, ndriçimi).

PEISAZHI

Impakti potencial: Ndryshime vizuale të peisazhit gjatë ndërtimit të rrugës dhe veprave. 23

Masat zbutëse:

Stokimi i materialeve do të bëhet në mënyrë të rregullt, duke evituar kaosin dhe krijimin e mjediseve të papastra. Menaxhimi i mbetjeve do të bëhet në mënyrën më të përshtatshme, në përputhje me normat në fuqi;

Pastrimi i përgjithshëm i gjithë zonës së punimeve pas përfundimit të tyre.

SHËNDETI PUBLIK

Impakti potencial: Ekspozim i popullsisë ndaj pluhurave, zhurmave dhe vibracioneve gjatë ndërtimit të rrugës dhe veprave.

Masat zbutëse:

Trafiku i mjeteve të rënda do të planifikohet me qëllim që të evitohen orët e pikut të trafikut dhe bllokimi i rrugëve;

Hyrja në zonën e ndërtimit do të bëhet jo nëpërmjet kalimit në zonat e banuara; Hyrja në zonën e ndërtimit do të jetë e kufizuar;

Aplikimi i të gjitha masave mbrojtëse të përshkruara për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (mbrojtja nga pluhurat, emetimet e gazeve, zhurmat, vibracionet, ndriçimi).

Mbledhja, transporti dhe menaxhimi i mbetjeve do të bëhet sipas normave dhe standarteve në fuqi.

TRASHËGIMIA KULTURORE DHE HISTORIKE

Nuk priten efekte të dëmshme. Gjithësesi, përpara fillimit të punimeve, rekomandohet evidentimi i vendeve ku ndodhen objektet e kultit ose objekte historikë, për të shmangur lëvizjen e mjeteve pranë tyre.

6. PROGRAM MONITORIMI

6.1 Qellimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor i projektit është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit gjatë dhe në mbyllje të tijë.
- Të monitorojë emetimet në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në zonen e projektit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me projektin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të projektit në rajon.
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajonin e projektit , në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

Baza Ligjore e Monitorimit

Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme.

Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:

- Ligji nr. 10431 datë 09.06.2013 “Për mbrojtjen e mjedisit”, kreu VI “monitorim i gjendjes së mjedisit”; Subjekti është i detyruar të kryejë monitorimet periodike sipas kërkesave të përcaktuara në kushtet e lejes përkatëse mjedisore.

Legjislacioni bazë ku mbështetet monitorimi janë:

Baza ligjore për monitorimin e projektit

Ligji Nr.10266 datë 15.4.2010	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis
Ligji 162/2014”	Per Mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis
VKM Nr.1189 datë 18.11.2009	Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit
VKM Nr. 435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë
VKM Nr. 803 datë 04.12.2003	Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit
Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527 datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkarkuar nga mjetet rrugore, dhe mënyra e kontrollit të tyre. I ndryshuar me: Udhëzimin Nr. 12 datë 15.06.2010
VKM Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse.
Ligj nr. 10463 dt. 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”	Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet: a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve; b) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre; c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

Në përputhje me karakteristikat e projektit dhe në përputhje me bazën ligjore mbi monitorimin, rekomandojmë të monitorohen këto elemente

Programi I Monitorimit

Nr	Indikatorët e Monitoruar	Çfarë parametri do të monitorohet?	Koha e monitorimit	Frekuenca e monitorimit?	Pergjegjesi a
1	Materialet , mbetje të gjeneruara nga procesi i gjurmimeve (dhera , inerte , etj)	Sasia, tipi i materialit (mbetjes së gjeneruar), depozitimi në shesh depozitim.	Gjatë periudhës së ndërtimit /gjurmimeve , në cdo kohë që do kemi gjenerim mbetjesh	Rregullisht /cdo ditë	Zhvilluesi i projektit
2	Emetimi i zhurmave ne (dB)	Niveli i zhurmave të emetuara në dB	Faza ndërtimore Matja e zhurmave me kontraktore të akredituar (përfshirë parametrin e zhurmave të akredituar)	Sipas kushteve të vendosura në Vendimin për Vlerësim Paraprak të Ndikimit në Mjedisit (nga Insitucionet e mjedisit)	Zhvilluesi i projektit
3	Emetimi i Pluhurave Pluhurat	Niveli i (PM10 ;PM2.5 ;TS P) Ne ambjentet e punes dhe ne periferi te	Vezhgime ne terren mbi nivelin e pluhurit. Matje e Pluhurit total ne ambjentet e punes dhe PM10 & TSP ne	Sipas kushteve të vendosura në Vendimin për Vlerësim Paraprak të	Zhvilluesi i projektit

Nr	Indikatorët e Monitoruar	Çfarë parametri do të monitorohet?	Koha e monitorimit	Frekuenca e monitorimit?	Pergjegjesi a
		sheshit të ndërtimit	periferi me kontraktore te akredituar (sipas kushteve te vendosura në Vendimin për Vlerësim Paraprak të Ndikimit në Mjedisit)	Ndikimit në Mjedisit (nga Insitucionet e mjedisit)	
4	Mbetjet urbane nga aktiviteti i punonjesve që operojne në këtë project	Saisa /tipi i mbetjes së gjeneruar , sasia e atyre që cohen për riciklim nga nënkontraktorët.	Gjatë fazës ndërtimore	Periodikisht cdo here qe krijohen sasi te mjaftueshme per nje ngarkese;	Zhvilluesi i projektit
5	Raste , aksidente/incidente potenciale të mundshme që shoqërohen me kontaminime të tokës	Regjistrohen / menaxhimi dhe përgjigja/ reagimi pas cdo kontaminimi /incidenti të mundshëm të ndodhur si dhe pasojat qe ka shkaktuar incidenti.	Faza ndërtimore	Sipas rasteve nëse do kemi incidente të tilla	Zhvilluesi i projektit
6	Monitorim i kushteve te vendosura në Vendimin për Vlerësim Paraprak të Ndikimit në Mjedisit (nga Insitucionet e mjedisit)	Monitorohen Rregjistrohen Raportohen Referuar kushteve te vendosura në Vendimin për Vlerësim Paraprak të Ndikimit në Mjedisit (nga Insitucionet e mjedisit)	Faza ndërtimore	Sipas kushteve te vendosura në Vendimin për Vlerësim Paraprak të Ndikimit në Mjedisit (nga Insitucionet e mjedisit)	Zhvilluesi i projektit

7. VLERESIMI I NDIKIMEVE POZITIVE QE MUND TE SJELLE ZHVILLIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

Zhvillimi i këtij projekti shoqerohet me efekte pozitive sociale si vijon:

- Permiresimin e rrjetit rrugor ne pergjithesi dhe zhvillimi urban i cili do te shoqerohet rrjedhimisht edhe permiresimine industrisë turistike te vendit, rritjen e cilesise se jetes per banoret dhe perdoruesit e rruges .
- Punësimi i përkohshem për komunitetin i cili do të të marrë pjesë drejtpërdrejt në proceset e ndërtimit gjë e cila do të sjellë një kontribut të dobishëm në të ardhurat familjare (hapja e vendeve të punës);
- Rritje të ardhurash për shërbimet shtesë që do të duhet të behen për punonjësit që do te merren me ndërtimin e këtij projekti.
- Rritje të ardhurash për shërbimet shtesë që do të duhet të behen për punonjësit që do te merren me ndërtimin e këtij projekti.
- Rritje të ardhurash nga taksat vendore për te gjitha shërbimet e ofruara.

8. KONKLUZIONE

Nga hartimi i këtij raporti paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis për projektin e propozuar , mund të konkludojmë që:

- Ndikimet potenciale mjedisore të evidentuara janë vlerësuar dhe trajtuar sipas standarteve ligjore, metodologjisë dhe rekomandimeve të kërkuara.
- Implementimi i këtij projekti me masat e parashikuara zbutese përfshirë planin e monitorimit , është garant i realizimit jo vetëm të objektivave por edhe të performancës mjedisore në përputhje të plotë me ligjet në fuqi , lidhur me nivelin e shkarkimeve në mjedis dhe mbrojtjen e saj.
- Nuk evidentohen ndikime sinjifikative të cilat do të ndikonin në cilësinë e mjedisit apo të atyre sociale nga implementimi i projektit.
- Projekti në teresi në terma mjedisore dhe sociale , konsiderohet projekt me impakte negative minimale dhe të perkoshme .

Nga analizimi i përmbajtjes së këtij raporti mund të konkludojmë që implementimi i këtij projekti nuk do të ketë impakte negative sinjifikative në mjedisin përreth zonës së projektit gjatë fazës ndërtimore të tij, ndërkohë që pas fazës ndërtimore falë implementimit të këtij projekti do të kemi përmisim të infrastrukturës rrugore, zhvillim të mëtejshëm të vlerave turistike, përmirësim të cilësisë së jetës për komunitetin.

PROJEKTUES:

“G&L CONSTRUCTION” sh.p.k

POROSITËS :

BASHKIA PRRENJAS